**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**
**DURRES**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Numri i Çështjes** | 71041-02056-11-2018 | **Data e Regjistrimit** | 9/7/2018 |
| **Numri i Vendimit** | 11-2018-6159 | **Data e Vendimit** | 12/3/2018 |

# VENDIM
# NE EMER TE REPUBLIKËS

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRES E PERBERE NGA:**

**KRYESUES:** Rexhep Bekteshi

**ANËTAR**

**SEKRETARE** Brunilda Dizdari

**Objekti:** Heqjen e masës së sigurimit "Sekuestro preventive" mbi pasuritë:
1- Njesia Ni me sipërfaqe 120 m2 ndodhur në katin perdhes-Njësi tregtare."Kontratë Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol.103 ,porositës Z,******* Sub".
2- Apartament banimi Ap.17 me Sip.91 .5 m2 ,me strukture 2+1 plus Veranda 24.8 m2 ndodhur në katin e dyte banimi. "Kontrate Aneks me Nr.Rep 185 the Kol.iO3 ,potositës Z.******* Sub".
3- Apartament banimi Ap. 18 me Sip. 86.8 m2 ,me struktune 2+1 ndodhur në katin e tnetë banimi. "Kontratë Aneks me Nr.Rep 185 the Kol.iO3 ,porositës Z.******* Sub".
4- Apartament banimi Ap.26 me Sip.86.8 m2 ,me strukture 2+1 ndodhur në katin e katërt banimi. "Kontrate Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol.103 ,porositës Z.******* Sub".
5- Apartament banimi Ap.31 me Sip.46.6 m2 ,me strukturë 1+1 ndodhur në katin e katërt banimi. "Kontrate Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol.103 ,porositës Z.******* Sub".
6- Apartament banimi Ap,32 me Sip.60.8 m2 ,me strukture 1+1 ndodhur ne katin e katért banimi. "Kontrate Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol. 103 ,porositës Z.******* Sub".
7- Apartament banimi Ap.35 me Sip.79. 1 m2 ,me strukturë 2+1 ndodhur ne katin e pestë banimi. "Kontratë Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol.103 ,porositës Z.******* Sub".
8- Apartament banimi Ap.49 me Sip. 100 m2 ,me strukture 2+1 ndodhur në katin e gjashte banimi. "Kontratë Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol.103 ,porositës Z.******* Sub".
9- Apartament banimi Ap.15 me Sip.46.3 m2 ,me strukturë 1+1 plus Veranda me sip .19.6 m2 ndodhur në katin e dyte banimi. "Kontratë Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol. 103 ,porositës Znj.******* *******.
10- Apartament banimi Ap.20 me Sip.86.6 m2 ,me strukture 2+1 udodhur ne katin e tretë banimi. "Kontrate Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol. 103 ,porositës Zn] .Aferdita *******.
11- Apartament banimi Ap.30 me Sip.53.2 m2 ,me strukturë 1+1 ndodhur në katin e katërt banimi. "Kontratë Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol. 103 ,porositës Znj.Af&dita *******.
12- Apartament banimi Ap. 1 me Sip.94. 1 m2 ,me strukturë 2+1 ndodhur në katin e pare bani

**Baza Ligjore :** Neni 274 i K.Pr.Penale.

**Përmbledhja e vendimit:**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES**

Në gjykim mori pjesë **Prokurorja e çështjes Ornela Rrumbullaku.**<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />

Gjykata shqyrtoi materialet e çështjes dhe provat e paraqitura e në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dëgjoi avokaten mbrojtëse Mariola Çaushi që përfaqësoi kërkuesit në gjykim si dhe kërkuesin ******* ******* , **që i kërkuan Gjykatës**:

-Pranimin e kërkesës së bërë sipas objektit të saj në zbatim të nenit 274 pika 3 të Kodit Procedurës Penale.

Prokurorja e çështjes Ornela Rrumbullaku në përfundim të shqyrtimit gjyqësor **i kërkoi**

**Gjykatës:**

-Të pranojë kërkesën e bërë nga kërkuesit, me përjashtim të kërkesës së kërkuesit ******* ******* , për heqjen e sekuestros dhe të një apartamenti banimi sipas çertifikatës së pronësisë me Nr. 1483536, datë 23.08.2017, me Nr. pasurie 9/366/ND.+1-63, Vol. 125, Fq. 89, në emër të ************** , Bledar ******* , ******* ******* , ******* ******* , ******* ******* e ******* ******* . Ky apartament është fituar me Vendimin gjyqësor Nr. 334, datë 03.03.2017 i formës së prerë, me vlerë 10.600 Euro e 2.332.000 lekë që ndodhet në katin e 10 të objektit 9 kate mbi tokë+1 kat nën tokë, në Lagjen Nr. 13, Plazh-Durrës pasi objekti i mësipërm nuk ka realisht kat të 10.

Vëren:

Se mbi bazën e kërkesës së bërë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës me Vendimin penal Nr. 106, datë 30.03.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur:<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />

**1.** Pranimin e kërkesës të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**2.** Vendosjen e masës së sigurimit “Sekuestro preventive” mbi pasurinë objekt 9 kate mbi tokë+1 kat nën tokë, i ndodhur në Pasurinë Nr. 9/219, Zona Kadestrale 8515 në Lagjen Nr. 13, Plazh-Durrës.

**3.** Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprim dhe që është zbatuar nga organi i hetimit.

Kërkuesit ******* *******, ******* ******* , ******* *******, ************** , Bledar ******* , ******* ******* , ******* ******* , ************* , ******* ******* , ******* **************, *******, ******* *******, ************** , ************** , ******* *******, ************** , ******* ******* e ******* ******* kanë paraqitur nëpërmjet avokates mbrojtëse të tyre Mariola Çaushaj, e pajisur me Prokurën e Posaçme me Nr. 1264 Rep. e Nr. 793 Kol., datë 04.07.2018 kërkesën për: -Heqjen e sekuestros preventive për pasuritë që ata disponojnë secili prej tyre në pasurinë objekt 9 kate mbi tokë+1 kat nën tokë të ndodhur në pasurinë Nr. 9/219, Zona Kadestrale 8518, në Lagjen Nr. 13, Plazh-Durrës.

Pasuritë, apartamente, njësi tregtare, garazhde, etj. që ata pretendojnë se u përkasin janë përshkruar në objektin e kërkesës së bërë dhe në gjykim u parashtrua që nga vendosja e sekuestros preventive me Vendimin penal Nr. 106, datë 30.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës u janë prekur të drejtat e tyre për posedimin e tyre.

Rezulton se objekti i mësipërm është ndërtuar në mënyrë të parregullt, fillimisht nga shoqëria “Blombo-Construksion” sh.p.k. me administrator Arben Binjaku, që nuk e ka tërhequr lejen e

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**
**DURRES**

ndërtimit dhënë me Vendimin Nr. 3, datë 09.07.2010 të K.R.R.T.-Durrës dhe më pas punimet kanë vazhduar nga shoqëria “Braka Construksion” sh.p.k. me administrator Amarild Braka, që ka përfituar të drejtat mbi objektin e mësipërm.

Personi nën hetim Amarild Braka ka vazhduar në mënyrë të paligjshme në 2 katet e fundit të godinës dhe ai në Zyrën e Aluznit Durrës ka paraqitur dokumente të rremë për legalizimin e objektit që realisht është 9 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë.

Për këto veprime të paligjshme janë nën hetim dhe disa ish zyrtarë të “Aluiznit” Durrës, Flamur Gjuzi, Helio Kuqi, Elvis Pengili e Skerdi Bello.

Nga hetimet e kryera del se kërkuesit ******* *******, etj. në objektin mbi të cilin është vendosur sekuestro preventive me Vendimin penal Nr. 106, datë 30.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës kanë në posedim apartamente, garazhde, e hapësira për njësi tregtare, dhe kanë kërkuar heqjen e sekuestros preventive për to, pasi u janë cënuar të drejtat e tyre.

Gjykata analizoi materialet e çështjes dhe konkludon se kërkesa e bërë nga kërkuesit është e mbështetur në prova e fakte dhe në ligj e duhet pranuar.

Përsa i përket kërkesës së bërë nga kërkuesi ******* ******* në lidhje me apartamentin e banimin sipas çertifikatës së pronësisë me Nr. 1483536, datë 23.08.2017 me Nr. pasurie 9/366/ND+1-63, Vol.125, Fq. 89, në emër të ************** , ******* ******* , ******* ******* , ******* ******* , ************* e ******* ******* , apartamenti i fituar me Vendimin gjyqësor Nr. 334, datë 03.03.2017 që ka marrë formë të prerë më datë 23.04.2017 dhe përcaktohet në katin e 10 të objektit, Gjykata vlerëson që kërkesa nuk duhet pranuar pasi ky kat nuk ekziston në objektin e mësipërm.

**Për keto arsye:**

Baza Ligjore:

**<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />**

Në zbatim të nenit 274 pika 3 të Kodit Procedurës Penale, Gjykata:

Vendosi:

1.Heqjen e masës së sigurimit “Sekuestro preventive” vetëm për pasuritë e kërkuesve ******* **************, ******* ********, ******* **************, ******* ******* , Bledar ******* , ******* ******* (******* ), ******* ******* , ******* ******* , ******* ******* , ******* **************, ******* , ******* *************, *******, **************, ******* *************, *******, ******* ******* e ******* Tata, si më poshtë:<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />

1. Njësia N1 me sipërfaqe 120 m2, e ndodhur në katin përdhe-Njësi tregtare. “Kontratë Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol.103, porositës Z.******* *******.

2. Apartament banimi Ap.17 me Sip. 91.5 m2, me strukturë 2+1 plus Veranda 24.8 m2 ndodhur në katin e dytë banimi. "Kontratë Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol. 103, porositës Z.******* *******.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**
**DURRES**

3. Apartament banimi Ap. 18 me Sip. 86.8 m2, me strukturë 2+1 ndodhur në katin e tretë banimi. "Kontratë Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol.103, porositës Z.******* *******".

4. Apartament banimi Ap.26 me Sip. 86.8 m2 ,me strukture 2+1 ndodhur në katin e katërt banimi. "Kontratë Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol. 103, porositës Z.******* *******".

5. Apartament banimi Ap.31 me Sip. 46.6 m2, me strukturë 1+1 ndodhur në katin e katërt banimi. "Kontratë Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol.103, porosites Z.******* *******".

6. Apartament banimi Ap.32 me Sip. 60.8 m2, me strukturë 1+1 ndodhur në katin e katërt banimi. "Kontrate Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol. 103, porositës Z.******* *******".

7. Apartament banimi Ap.35 me Sip.79.1 m2, me strukturë 2+1 ndodhur në katin e pestë banimi. "Kontratë Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol.103, porosites Z.******* *******".

8. Apartament banimi Ap.49 me Sip. 100 m2, me strukturë 2+1 ndodhur në katin e gjashtë banimi. "Kontratë Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol.103, porositës Z.******* *******".

9. Apartament banimi Ap.15 me Sip. 46.3 m2, me strukturë 1+1 plus Veranda me sip. 19.6 m2 ndodhur në katin e dytë banimi. "Kontratë Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol. 103, porositës Znj.******* *******".

10. Apartament banimi Ap.20 me Sip. 86.6 m2, me strukturë 2+1 ndodhur në katin e tretë banimi. "Kontratë Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol.103, porositës Znj.******* *******".

11. Apartament banimi Ap.30 me Sip.53.2 m2, me strukturë 1+1 ndodhur në katin e katërt banimi. "Kontratë Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol.103, porositës Znj.******* *******".

12. Apartament banimi Ap.1 me Sip. 94.1 m2, me strukturë 2+1 ndodhur në katin e parë banimi. "Kontrate Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol.103, porositës Znj.******* ******* ".

13. Apartament banimi Ap.37 me Sip. 63.5 m2, me strukturë 1+1 ndodhur në katin e pestë banimi. "Kontratë Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol. 103, porositës Znj.******* ******* ".

14. Apartament banimi Ap.40 me Sip. 60.8 m2, me strukturë 1+1 ndodhur në katin e pestë banimi. "Kontratë Aneks me Nr.Rep 185 dhe Kol.103, porositës Znj.******* ******* ".

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

15. Apartament banimi Ap.24 me Sip. 60.8 m2, me strukturë 1+1 ndodhur në katin e tretë banimi. "Kontratë Aneks me Nr.Rep 179 dhe Kol. 98, porositës Z.******* ******* ".

16. Apartament banimi Ap.21 me Sip. 63.5 m2, me strukturë 1+1 ndodhur në katin e tretë banimi. "Kontratë Aneks me Nr.Rep 179 dhe Kol. 98, porositës Z.************* ".

17. Apartament banimi Ap.48 me Sip. 60.8 m2, me strukturë 1+1 ndodhur në katin e gjashtë banimi. "Kontratë Aneks me Nr.Rep 179 dhe Kol. 98, porositës Znj.******* ******* ".

18. Apartament banimi Ap.55 me Sip. 57.6 m2, me strukturë 1+1 ndodhur në katin e tetë banimi. "Kontratë Aneks me Nr.Rep 179 dhe Kol. 98, porositës Znj.******* ******* , ************** dhe Bledian ******* ".

19. Aparatament banimi Ap.39 me Sip. 41.2 m2. Pasuria me Nr. 9/366-ND+1-39 me ndodhje në katin e gjashtë. "Kontratë për Shit-Blerjen pasuri të paluajtshme me Nr.Rep.821 dhe Nr.Kol. 484, me blerës Znj.******* *******".

20. Apartament banimi Ap.50 me Sip. 45 m2+Veranda 27 m2. Pasuria me Nr.9/366-ND+150 me ndodhje në katin e tetë. "Kontratë për Shit-Blerjen pasuri të paluajtshme me Nr.Rep.2168 dhe Nr.Kol. 1392, me blerës Z.******* *******".

21. Garazh Gi me Sip.753.4 m2. Pasuria me Nr. 9/366-ND+1-G1 me ndodhje në katin e parë. "Kontratë për Shit-Blerjen pasuri të paluajtshme me Nr.Rep. 1757 dhe Nr.Kol. 1059, me blerës Z. ******* *******përfaqësuar nga vëllai i tij Besim *******.

22. Apartament banimi Ap.25 me Sip. 100 m2, ku 88.5 m2 është sipërfaqe banimi, 11.5 m2 sipërfaqe e përbashkët me ndodhje në katin e tretë. "Kontratë për Sipermarrje (Pronotim) pasuri të paluajtshme me Nr.Rep. 342 dhe Nr.Kol. 187, me porositës Z.******* *******.

2.Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

3.Dosja penale e mësipërme t'i bashkëngjitet dosjes gjyqësore që i përket Vendimit penal Nr. 106, datë 30.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës të caktimit të masës së sigurimit "Sekuestro preventive".

4.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Durrës brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së tij.

**U shpall sot më datë 27.11.2018.**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.